

Mbahet punëtorja rajonale për të ardhmen e Edukimit të artë në shkencat bujqësore

02/11/2021

Më 01 - 02.11.2021 në Universitetin Bujqësor të Tiranës (UBT) në kuadër të projektit DualAFS u mbajt punëtorja për të ardhmen e edukimit të lartë në shkencat bujqësore. Në punëtori morën pjesë përfaqësuesit e të gjithë partnerëve në projekt.

Në këtë takim nga Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë – FBV morën pjesë Prof.Asoc. Muhamet Kamberi, Prof. Dr. Arben Mehmeti dhe Prof. Asoc. Alltane Kryeziu.

Prof. Asoc. Muhamet Kamberi nga FBV mbajti prezantimin rreth **Higher education in agriculture sciences in Kosovo.**

Kati Partanen nga Savonia University of Applied Sciences (SUAS) mbajti prezantimin rreth sfidave dhe të ardhmes së shkencave bujqësore.

Rezultatet e pakos punuese (PP2) për **Survey on skills needs and the role of Work Life Partners in Dual tertiary education in the livestock science and agribusiness in Albania and Kosovo** u prezantuan nga Prof. Ardita Jahja-Hoxha.

Prof. Hannu Viitala nga SUAS përmes lidhjes nga distanca diskutoi për rolin e të mësuarit elektronik (e-learning) dhe përdorimin e kurseve të shkurtra për mësim të vazhdueshëm.

Në fund u mbajt edhe një panel diskutimi rreth kësaj teme i udhëhequr nga Prof. Dr. Fatbardh Sallaku, rektori i UBT, në të cilin morën pjesë ekspertë të fushës dhe përfaqësuesi i bizneseve shqiptare. Diskutimi u vlerësua si i frytshëm dhe me këtë diskutim punëtorja i përmbylli punimet.



